Emertimi dhe Forma ligjore	**"GPG COMPANY" SHPK**
NIPT -i	**J 64324443 V**
Adresa e Selise	Lagja "18 Tetori" Lushnje
	Lushnje
Tel:	+ 35535225985
Data e krijimit	12.01.1996
Nr. i Regjistrit Tregetar	3002744
Veprimtaria Kryesore	SHERBIME NE FUSHEN E NDERTIMEVE

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbarim te Standartit Nderkombetar te Raportimit Financiar Nr.1 dhe
Ligjit Nr. 25/2018 Date 25.05.2018 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2022

Pasqyra Financiare jane individuale		Po
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara		Jo
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne		Leke
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne		Leke
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga	01.01.2022
	Deri	31.12.2022
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare		24.03.2023

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import - Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

Pasqyrat financiare te vitit 2022
"G.P.G. COMPANY" SH.P.K.
NIPT J64324443V

Pasqyra e Pozicionit Financiar *Me ndarje ne afatshkurter dhe afatgjate*	**Periudha Raportuese**	**Periudha Raportuese**
AKTIVET		
Aktive afatgjate		
Aktive afatgjata materiale	364,976,225	317,780,716
Aktive afatgjata materiale per investim		
Emri i mire	112,048,468	112,048,468
Aktive te tjera afatgjata jo-materiale		
Investime ne pjesmarrje	620,214,567	489,821,759
Investime ne bashkime ekonomike (joint-ventures)		
Aktivet tatimore te shtyra		
Kerkesa per qira financiare afatgjata		
Huadhenie afatgjata		
Aktivet biologjike	92,329,341	92,329,341
Aktive te tjere financiare afatgjate		
Aktive te tjera (pershkruaj)		
Totali i aktiveve afatgjata	**1,189,568,601**	**1,011,980,284**
Aktive afatshkurtra		
Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter	23,732,992	44,582,813
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	3,709,035,173	2,391,337,146
Kerkesa ne lidhje me kontratat e ndertimit		
Aktive te tjere financiare afatshkurter		
Tatim fitimi i parapaguar		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	639,519,410	629,224,905
Aktive te tjera (pershkruaj)		
	4,372,287,575	**3,065,144,864**
Aktive te klasifikuara si te mbajtura per shitje dhe te perfshira ne grupet e nxjerjes jashte perdorimit te klasifikuara si te mbajtura per shitje ne perputhje me SNRF5		
Totali i aktiveve afatshkurtra	**4,372,287,575**	**3,065,144,864**
TOTALI I AKTIVEVE	**5,561,856,176**	**4,077,125,148**
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nenshkruar dhe primi i kapitalit	1,550,270,990	1,286,270,990
Rezerva te tjera (pershkruaj)	289,532,056	365,178,055
Fitime/(humbje) te mbartura	507,059,557	288,354,001
	2,346,862,603	**1,939,803,046**
Shuma te njohura direkt ne kapital ne lidhje me aktivet e mbajtur per shitje		
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	**2,346,862,603**	**1,939,803,046**
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	**2,346,862,603**	**1,939,803,046**
Detyrime afatgjata		
Huamarrje	1,399,298,607	762,722,879
Detyrime financiare te tjera		
Detyrime per perfitime pensionesh		
Detyrime tatimore te shtyra		
Provizione		
Te ardhura te shtyra		
Detyrime te tjera (pershkruaj)		
Totali i detyrimeve afatgjata	**1,399,298,607**	**762,722,879**
Detyrime afatshkurtra		
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	1,768,621,550	1,324,532,933
Detyrime ndaj klienteve per kontratat e ndertimit		
Huamarrje	-	48,475,972
Detyrime financiare te tjera		
Detyrime per tatimin aktual	47,073,416	1,590,318
Provizione		
Te ardhura te shtyra		
Detyrime te tjera (pershkruaj)		
	1,815,694,966	**1,374,599,223**
Detyrimet e perfshira ne grupet e nxjerjes jashte perdorimit te klasifikuara si te mbajtura per shitje ne perputhje me SNRF5		
Totali i detyrimeve afatshkurta	**1,815,694,966**	**1,374,599,223**
Detyrime totale	**3,214,993,573**	**2,137,322,102**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	**5,561,856,176**	**4,077,125,148**

G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

Pasqyrat financiare te vitit 2022
"G.P.G. COMPANY" SH.P.K.
NIPT J64324443V
Lek/Mije Lek/Miljon Lek
Pasqyra e Performances *(sipas natyres)*

	Periudha Raportuese	Periudha Raportuese
Aktivitetet e vazhdueshme		
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	4,164,336,491	3,409,004,492
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1		
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2		
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3		
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	-	25,973,750
Te ardhura nga investimet		
Te ardhura te tjera	-	32,363,680
Ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces		
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(2,019,734,946)	(2,006,112,126)
Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi	(56,302,158)	(34,513,340)
Shpenzime personeli	(177,783,861)	(170,848,633)
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	(44,533,605)	(6,249,778)
Shpenzime te tjera	(1,268,997,331)	(910,362,705)
Pjesa e fitimit/(humbjes) nga pjesmarrjet (filjal/dege)		
Pjesa e fitimit/(humbjes) nga bashkimet ekonomike (joint-venture)		
Fitime te njohura nga shitja e pjesmarrjeve		
Te tjera *(pershkruaj)*		
Fitimi/(humbja) para tatimit	**596,984,590**	**339,255,340**
Tatimi mbi fitimin	(89,925,033)	(50,901,339)
Fitimi/(Humbja) e periudhes nga aktiviteti i vazhdueshem	**507,059,557**	**288,354,001**
Aktivitetet e nderprera		
Fitimi/(Humbja) e periudhes nga aktivitetet e nderprera		
Fitimi/(Humbja) e periudhes (A)	**507,059,557**	**288,354,001**
Fitimi/(Humbja) per:		
Zoteruesit e njesise ekonomike meme		
Interesat e pakices		
Fitimet per aksion		
Nga aktivitetet e vazhdueshme dhe te nderprera		
Fitimet Baze per Aksion		
Fitimet e Pakesuara per Aksion		
Nga aktivitetet e vazhdueshme		
Fitimet Baze per Aksion		
Fitimet e Pakesuara per Aksion		
Fitimi/(Humbja) e periudhes (A)	**507,059,557**	**288,354,001**
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese		
Vlera qe nuk do te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje		
Fitime nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Pjesa e te ardhurave gjitheperfshirese nga pjesmarrjet		
Te tjera *(pershkruaj)*		
Tatim fitimi i vlerave qe nuk do te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje		
Shuma	-	-
Vlera qe mund te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje		
Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja		
Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje		
Fitime/(Humbje) nga mbrojtja nga fluksi i mjeteve monetare (Cash Flow Hedges)		
Te tjera *(pershkruaj)*		
Tatim fitimi i vlerave qe mund te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje		
Shuma	-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per periudhen pas tatimit (B)	-	-
Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per periudhen (A+B)	**507,059,557**	**288,354,001**

Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per :
Zoteruesit e njesise ekonomike meme
Interesat e pakices

REPUBLIKA E SHQIPERISE
IMPORT - EXPORT
G.P.G.CO SH.P.K
NIPT:J64324443V
LUSHNJE ALBANIA

Pasqyrat financiare te vitit 2022
"G.P.G. COMPANY" SH.P.K.
NIPT J64324443V
Lek/Mije Lek/Miljon Lek
Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare *(metoda indirekte)*

	Periudha Raportuese	Periudha Raportuese
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	507,059,557	288,354,001
Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:		
Amortizimin	56,302,158	34,513,340
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivitete investuese		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Renie/(Rritje) ne - *LLA tregare dhe të tjera të arkëtueshme*	(1,317,698,027)	(748,366,822)
Renie/(Rritje) ne - *inventarë*	20,849,821	(33,362,105)
Renie/(Rritje) ne - *LLP dhe të tjera të pagueshme*	441,095,743	255,768,331
Rritje/(Renie) ne - *pershkruaj*		
Rritje/(Renie) ne - *pershkruaj*		
Rritje/(Renie) ne - *pershkruaj*		
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	**(292,390,748)**	**(203,093,255)**
Tatim fitimi i paguar gjate periudhes		
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Blerje e filialit X, neto nga mjetet monetare të blera	(130,392,808)	(159,212,095)
Blerje e tokës, ndërtesës, makinerve dhe pajisjeve	(103,497,667)	184,023,487
Emri I mire	0	0
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	**(233,890,475)**	**24,811,392**
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Shuma te arketuara nga huamarrje afatgjate	636,575,728	(29,564,504)
Dividendët e paguar	(100,000,000)	(100,000,000)
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Pershkruaj		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	**536,575,728**	**(129,564,504)**
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	**10,294,505**	**(307,846,367)**
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	629,224,905	937,071,272
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	**639,519,410**	**629,224,905**

G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

Pasqyrat financiare te vitit 2022
"G.P.G. COMPANY" SH.P.K.
NIPT J64324443V
Lek/Mije Lek/Miljon Lek
Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto

	Kapitali i nenshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva rivleresimi	*Rezerva te tjera (pershkruaj)*	*Rezerva te tjera (pershkruaj)*	nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja	Fitimet/ (humbjet) e pashperndara	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali	Interesa jo-kontrollues	Totali
Pozicioni financiar ne fillim	**1,286,270,990**	**-**	**-**	**100,996,162**	**-**	**-**	**-**	**364,181,893**	**1,751,449,045**	**-**	**1,751,449,045**
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile									0		0
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fi	**1,286,270,990**	**0**	**0**	**100,996,162**	**0**	**0**	**0**	**364,181,893**	**1,751,449,045**	**0**	**1,751,449,045**
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:									0		0
Fitim/(humbja) e periudhes								288,354,001	288,354,001		288,354,001
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese									0		0
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital									0		0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**288,354,001**	**288,354,001**	**0**	**288,354,001**
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:				264,181,893				(264,181,893)	(264,181,893)		(264,181,893)
Emetim i kapitalit të nënshkruar											0
Dividende te shperndare								(100,000,000)	(100,000,000)		(100,000,000)
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes *(pershkruaj)*									0		0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**(100,000,000)**	**(100,000,000)**	**0**	**(100,000,000)**
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)	**1,286,270,990**	**0**	**0**	**365,178,055**	**0**	**0**	**0**	**288,354,001**	**1,939,803,046**	**0**	**1,939,803,046**
									0		0
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:									0		0
Fitim/(humbja) e periudhes								507,059,557	507,059,557		507,059,557
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese									0		0
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital									0		0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**507,059,557**	**507,059,557**	**0**	**507,059,557**
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:	264,000,000			(75,645,999)				(188,354,001)	0		0
Emetim i kapitalit të nënshkruar									0		0
Dividende te shperndare								(100,000,000)	(100,000,000)		(100,000,000)
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes *(pershkruaj)*								0	0		0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	**264,000,000**	**0**	**0**	**(75,645,999)**	**0**	**0**	**0**	**(288,354,001)**	**(100,000,000)**	**0**	**(100,000,000)**
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	**1,550,270,990**	**0**	**0**	**289,532,056**	**0**	**0**	**0**	**507,059,557**	**2,346,862,603**	**0**	**2,346,862,603**

1. Mjedisi

a- Organizimi dhe operacionet

Shoqeria "GPG COMPANY" shpk eshte krijuar ne vitin 1996 dhe ka si objekt ndertime te te gjitha llojeve.
Kapitali i nenshkruar ne shoqeri perbehet nga 2 kuota, per vleren totale **1,550,270,990 leke** dhe zotërohet nga ortaket :
-Z.Paqsor BUZI i cili zoteron një kuote, me vlerën nominale **790,638,205 leke**, ose 51% te kapitalit,qe ndahet Kapital ne para per Shumen **790,638,205** leke.
-Z.Gezim Dani i cili zoteron një kuote, me vlerën nominale **759,632,785 leke**, ose 49% te kapitalit,qe ndahet Kapital ne para per Shumen **759,632,785** leke
Gjate vitit 2022 shoqria ka pasur mesatarish 297 punonjes .

2. Politikat kontabël kryesore

2.1 Bazat e përgatitjes

a- Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe të pranuara nga Unioni Europian si dhe ligjin Nr-25/2018 per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

b- Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike

c- Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në monedhën kombëtare të Republikës së Shqipërisë Lekë (LEK), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Informacioni financiar i paraqitur në Lekë është përafruar në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

2.2 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e saj operacionale edhe për një të ardhme të parashikuar.

2.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën përkatëse funksionale duke përdorur kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedha të huaja në datën e raportimit rikonvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit në atë datë. Fitimet dhe

humbjet nga këmbimi që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj dhe nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehur në monedhë të huaj njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.4 Instrumentat financiarë

Shoqëria i klasifikon instrumentat financiarë në kategoritë e mëposhtme: Instumenta të tregtueshme të matura me vlerën e drejtë përmes fitimeve dhe humbjeve, huatë dhe të arkëtueshme, investime të mbajtura deri në maturim dhe aktive financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë blerë investimet. Drejtimi i shoqërisë përcakton klasifikimin e investimeve të tij në njohjen fillestare dhe rivlerëson këto investime në çdo datë raportimi.

(a) Aktive financiare të matura me vlerën e drejtë përmes fitimeve dhe humbjeve
Aktive financiare të matura me vlerën e drejtë përmes fitimeve dhe humbjeve janë aktive financiare të tregtueshme. Një aktiv financiar klasifikohet në këtë kategori nëse blihet kryesisht për qëllimin e shitjes në përiudhën afatshkurtër. Aktivet në këtë kategori klasifikohen si aktive afatshkurtra, që do të thotë shiten brenda një periudhe 12 mujore për qëllim të këtyre pasqyrave financiare. Gjatë vitit, Shoqëria nuk ka mbajtur ndonjë investim në këtë kategori.

(b) Huatë dhe të arkëtueshme
Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare joderivativë me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv. Ato përfshihen në aktive afatshkurtra, përveç atyre që kanë një afat maturimi më të madh se 12 muaj pas datës së bilancit. Ato klasifikohen si aktive afatgjata.
Huatë dhe të arkërueshmet e Shoqërisë përbëhen nga 'llogari të arkëtueshme tregëtare dhe të tjera të arkëtueshme' dhe 'mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare' në bilanc. Huatë dhe të arkëtueshmet mbahen në bilanc me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interest efektiv.

(c) *Investime të mbajtura deri në maturim*
Investime të mbajtura deri në maturim janë investime me afat maturimi të përcaktuar dhe drejtimi i Shoqërisë ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë ti mbajë deri në maturim. Këto letra me vlerë klasifikohen si aktive afatgjata, përveç letrave me vlerë që arrijnë afatin e maturimit brenda 12 muajve të ardhshëm nga data e bilancit dhe që njihen si afatshkurtra gjatë periudhës raportuese. Gjatë vitit, Shoqëria nuk ka mbajtur ndonjë investim në këtë kategori.

(d) *Aktivet financiare të vlefshme për shitje*
Aktivet financiare të vlefshme për shitje janë investime jo derivativë që blihen me qëllim që të mbahen për një periudhë kohe të pacaktuar dhe që mund të shiten kur Shoqëria ka nevojë për burime financiare ose me ndryshimin e normave të interest. Ato përfshihen në aktive afatgjata vetëm nëse drejtimi synon ti shesë Brenda 12 muajve nga data e bilancit ose të mund ti përdorë ato si burim i kapitalit punues. Në këtë rast këto investime

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Import - Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

klasifikohen si aktive afatshkurtra. Gjatë vitit, Shoqëria nuk ka mbajtur ndonjë investim në këtë kategori.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga vlerat monetare në arkë, llogaritë rrjedhëse në banka dhe depozita afatshkurtra likuide.

Kontabiliteti i shpenzimeve dhe të ardhurave financiare është diskutuar në shënimin 2.13.

2.5 Aktivet Afatgjata Materiale

Aktivet Afatgjata Materiale paraqiten me koston historike minus amortizimin e akumuluar, minus humbjet e akumuluara nga rënia e vlerës, nëse ka. Kosto historike përfshin të gjitha shpenzimet që lidhen direkt me blerjen e tyre. Shpenzimet e mëpasshme përfshihen në vlerën e mbartur të aktiveve ose njihen si një aktiv më vete, vetëm nëse është e mundur se përfitime ekonomike të lidhura me to do të hyjnë në Shoqëri dhe vlera e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha shpenzimet për riparim dhe mirëmbajtje paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

Amortizimi regjistrohet mbi bazën e vleres se mbetur kontabel për të shpërndarë koston e aktiveve afatgjata gjatë jetëve të dobishme të vlerësuara të tyre. Amortizimi njihet duke filluar nga muaji pasardhës i blerjeve. Normat e amortizimit të zbatuara për aktivet janë si më poshtë:

Përshkrimi	% e Amortizimit
Ndërtesat	5
Makineritë dhe Paisjet	20
Mjete Transporti	20
Paisje Zyre	20
Paisje kompjuterike	25

Vlera e mbetur e aktiveve dhe jeta e dobishme e tyre rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme në çdo datë bilanci.

Një humbje nga rënia në vlerë e një aktivi njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa shuma e rikuperueshme e tij. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Fitimet dhe humbjet nga shitja ose nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi njihën në shumë neto në zërin 'të ardhura të tjera' në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e huamarrjes paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.6 Inventarët

Inventarët vlerësohen në bilanc me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Import - Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT: J64324443V LUSHNJE ALBANIA

realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet sipas metodës së kostos meatare të ponderuar dhe përfshin të gjitha shpenzimet që ndodhin në blerje dhe gjatë transferimit të tyre në vendodhjen dhe konditat ekzistuese. Vlera e realizueshme neto është është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur shpenzimet e vlerësuara të përfundimit dhe të shitjes.

2.7 Rënia e vlerës

Aktivet Financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi. Nëse egziston një evidencë e tillë, aktivi financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për rënie vlere
Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje më rreziqet krediturese.
Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me njëngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivet jo financiarë

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktiv rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen me një normë skontimi para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.
Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudha të mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eleminimit të humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Import - Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

masën në të cilën vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën e aktivit që duhej të përcaktohej, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

2.8 Përfitimt e punonjësve

Planet e kontributeve të përcaktuara

Një plan kontributesh i përcaktuar është një plan përfitimesh post punësim sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute fikse në një njëi tjetër specifike dhe nuk do të ketë asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar shuma të tjera. Detyrimet për kontribute në plane të caktuara pensionesh si psh Fondi Shqiptar i Pensioneve Shtetërore njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur bëhen të pagueshme.

Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve nuk vlerësohen mbi bazën e aktualizimit dhe shpenzohen ndërsa sigurohet shërbimi i lidhur me to. Një detyrim njihet për shumën e pritshme për tu paguar të përfitimeve afatshkurtra nëse Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer në të kaluarën nga punnjësit dhe nëse detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

2.9 Kapitali aksionar

Aksionet e Zakonshem të emetuara klasifikohen si kapital aksionar.

2.10 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkohen flukse dalëse mjetesh monetare për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të mjeteve monetare me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit.

2.11 Huamarrjet / Huadhëniet

Huamarrjet / huadhëniet paraqiten dhe vlerësohen fillimisht me vlerën e drejtë pa përfshirë shpenzimet e transaksionit. Pas njohjes fillestare, huadhëniet dhe huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në interesin efektiv të çdo diference midis kostos dhe vlerës së riblerjes përgjatë periudhës së huamarrjes.

Huamarrjet / huadhëniet janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përveç rastit kur

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Import - Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ndodhin.

2.12 Të ardhurat

Mallrat e shitura

Të ardhurat nga shitja e mallrave janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumave të arkëtuara ose të pritshme për tu arkëtuar, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, akciza, kthimet dhe ulet, skontove tregëtare dhe financiare. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të lidhura me pronësinë transferohen tek blerësi, kur ka mundësi që përfitimet të lidhura me shitjen të hyjnë në Shoqëri, kostot dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, drejtimi nuk përfshihet më në administrimin dhe kontrollin efektiv të mallrave dhe kur vlera e të ardhurave mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.
Transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve ndryshon nga termat individual të kontatës së shitjes. Transferimi zakonisht ndodh kur mallrat merren në magazinën e blerësit.

Komisionet e ndërmjetësve

Kur Shoqëria vepron si shoqëri kryesore duke përdorur një ndërmjetës në një transaksion, të ardhuart njihen në shumën neto pas zbritjes së komisioneve të paguara nga Shoqëria.

Pagesat e qerasë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiramarrësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e qirave të zakonshme njihen me metodën lineare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së qirasë.
Stimujt e marë në një Qira të zakonshme njihen si pjesë integrale e shpenzimeve të qirasë përgjatë periudhës së qirasë.

2.13 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi baza neto.

REPUBLIKË SË SHQIPËRISË Import-Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

2.14 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, në këtë rast tatimi njihet në kapital.
Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat neto te tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Te ardhurat e tatueshme nuk perfshijne shpenzimet e panjohura per qellim te tatimit mbi fitimin sipas legjislacionit ne fuqi
Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumat e përdorura për qëllime tatimore.
Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin e miratuar në datën e raportimit.
Detyrimet dhe aktivet tatimore të shtyra kompesohen nëse ka një marëveshje ligjore për ti kompesuar dhe nëse ato lidhen me tatime mbi fitimin të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor.
Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme tatimore të vlefshme që diferencat e përkohshme mund të përdoren kundrejt tyre.
Në 31 Dhjetor 2019 nuk është njohur asnjë aktiv tatimor i shtyrë ndërsa drejtimi vlerëson që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

2.15 Standarte dhe interpretime të reja ende të pa adoptuara.

Një sërë standartesh të reja, ndryshime apo interpretime të tyre ende nuk janë bërë efektive për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2022, dhe nuk janë aplikuar ende nga Shoqëria në operacionet e saj dhe në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

3. Menaxhimi i rrezikut financiar

Manaxhimi i rreezikut është një element i rëndësishëm i operacioneve të Shoqërisë. Rreziqet kryesore me të cilat përballet Shoqëria janë ato që lidhen me rrezikun e tregut, i cili përfshin rrezikun e çmimit, të normës së interesit dhe të kursit të këmbimit, rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

3.1 Politikat dhe proçedurat për manaxhimin e rrezikut

Politikat e Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut kanë për qëllim të identifikojnë, analizojnë dhe drejtojnë rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, të përcaktojnë kufijtë e rrezikut dhe të sigurojnë që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda
këtyre kufijve. Politikat dhe proçedurat për manaxhimin e riskut rishikohen rregullisht

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Import Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe paraqitjen e praktikës më të mirë.
Drejtimi i Shoqërisë në bashkëpunim të ngushtë me dhe mbikqyrjen nga strukturat e manaxhimit të riskut ka përgjegjësi të plotë për mbikqyrjen e kuadrit të manaxhimit të riskut, mbikqyrjen e manaxhimit të rreziqeve kryesore dhe rishikimin e politikave dhe proçedurave të tij të manaxhimit të rrezikut sikurse miratimin e transaksioneve të rëndësishme dhe me shuma të konsiderueshme

Si faktorët e rrezikut të brendshëm ashtu edhe ato të rrezikut të jashtëm janë identifikuar dhe manaxhuar përgjatë gjithë strukturës organizative të Shoqërisë, dhe veçanërisht nga strukturat e manaxhimit të riskut në nivel grupi.

3.1.1 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut, kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Rreziqet e tregut përbëhen nga rreziku i kursi të këmbimit, rreziku i normës së interest dhe rreziku i çmimit. Rreziku i tregut vjen nga pozicionet e hapura në normat e interest, kurset e këmbimit dhe element të tjerë të cilët janë ekspozuar ndaj ndryshimeve të përgjithshme dhe specifike të tregut dhe ndryshimeve në nivelin e qëndrueshmërisë së çmimeve të tregut.
Objektivi i manaxhimit të riskut të tregut është të drejtojë dhe kontrollojë ekspozimin e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm.

3.1.2 Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që mund të shkaktojë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vleren e portofolit të investimeve, ndryshimi në normat e interesit.
Të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset monetare operative janë pothuajse të pavarura nga ndryshimet në normat e interest të tregut pasi Shoqëria nuk ka aktive financiare të cilat mbartin interes. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë kryesisht huamarrjet dhe huadhëniet me norma interesi të ndryshueshme duke ndryshuar flukset e ardhshme monetare. Drejtimi i Shoqërisë nuk ka një politikë zyrtare të përcaktimit të shumave të dhëna ose të marra hua me norma interesi fikse ose të ndryshueshme. Megjithatë, në kohën e huamarrjeve të reja, drejtimi përdor gjykimin e tij për të vendosur nëse ai beson se një normë interesi fikse ose e ndryshueshme do të ishte më e favorshme për Shoqërinë gjatë periudhës deri në maturim.

3.1.3 Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ka aktive dhe detyrime të shprehura në USD dhe në Euro. Rreziku i kursit të këmbimit lind kur aktivet aktuale ose të parashikuara në një monedhë të huaj janë më të mëdha ose më të vogla se detyrimet në atë monedhë.

3.1.4 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku që një palë në një instrument financiar të shkaktojë një

REPUBLIKA E SHQIPËRISË IMPOSTI I TVSH-SË G.P.G.CO SHPK NIPT: K63244443V LUSHNJE ALBANIA

humbje financiare ndaj palës tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi dhe vjen kryesisht si pasojë e llogarive të arkëtueshme të Shoqërisë nga klientët e saj

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të çdo klienti. Shoqëria ka njohur një zbritje për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme që pasqyron vlerësimin e saj për humbjet e pritshme në lidhje me llogaritë e arkëtueshme tregëtare dhe të tjera të arkëtueshme. Zbritja është llogaritur mbi bazën e analizës individuale për klientët.

3.1.5 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që Shoqëria të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Përqasja e Shoqërisë për të manaxhuar likuiditetin është që të sigurojë aq sa është e mundur se do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj kur ato kërkohen si në kushte normale dhe jonormale pa shkaktuar humbje të papranueshme ose të rrezikojë dëmtimin e emrit të Shoqërisë.

Shoqëria sigurohet zakonisht se ka mjete të mjaftueshme monetare për të paguar shpenzimet e pritshme operacionale, duke përfshirë shërbimin e detyrimeve financiare, kjo përjashton ndikimin e mundshëm të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen si psh. Fatkeqësitë natyrore.

3.2 Manaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e saj për vijimësi të biznesit me qëllim të mundësimit të kthyeshmërisë për aksionarët dhe të përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit.
Totali i kapitalit nën administrim është i barabartë me kapitalin siç tregohet në bilancin kontabël plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si huamarrjet totale siç tregohet në bilancin kontabël minus mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.
Shoqëria është financuar me kapitalin minimal dhe kryesisht me huamarrje të brendshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura. Shoqëria kontrolluese ka konfirmuar për Shoqërinë se është në politikën e saj aktuale të sigurohet se Shoqëria është në gjendje të shlyejë borxhet e saj dhe angazhimet e saj për shpenzimet në lidhje me investimet kapitale kur ato kërkohet të paguhen. Shoqëria kontrolluese ka konfirmuar gjithashtu Shoqërinë se do ta mbështesë atë për tu siguruar se ato do të kenë fondet e nevojshme për të shlyer detyrimet e tyre kur ato kërkohet të paguhen.

Shoqëria nuk ka kërkesa të vendosura nga jashtë në lidhje me kapitalin.

4. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël

Drejtimi i Shoqërisë ka bërë një sërë vlerësimesh, gjykimesh dhe supozimesh në lidhje me raportimin e aktiveve dhe detyrimeve, dhe shpjegimin e aktiveve dhe detyrimeve të kushtëzuara në përgatitjen e pasqyrave financiare sipas SNRF. Rezultatet aktuale mund të

REPUBLIKË SË SHQIPËRISË Import - Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V BUSHNJE ALBANIA

ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e mëposhtme rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe ndryshimet njihen në periudhën në të cilën janë bërë vlerësimet dhe në periudhat e ardhshme

Në mënyrë të veçantë, informacioni për pjesë specifike të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimet kritike për zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare, përfshihet në shënimet e mëposhtme:

5. Informacion krahasues

Paraqitja e disa titujve në bilanc që lidhen me llogaritë e arkëtueshme tregëtare afatgjata, të tjera të arkëtueshme, huamarrje afatshkurtra dhe afatgjata, të tjera të pagueshme, diferencat nga konvertimi dhe rezerva të tjera në kapital dhe e disa titujve në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhen me kostot e shitjes dhe shpërndarjes, shpenzimet administrative dhe të ardhura (shpenzime) të tjera u ndryshua për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2022 për të paraqitur më mirë natyrën e transaksioneve sipas kerkesave te SNRF. Informacioni krahasues nuk është riklasifikuar për të konfirmuar ndryshimet në paraqitje në vitin aktual sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

Mjedisi i shfrytëzimit të Shoqërisë

Legjislacioni tatimor dhe doganor në Republikën e Shqipërisë është subjekt i interpretimeve të ndryshueshme dhe ndryshimeve të shpeshta, dhe shumë njësi ekonomike që operojnë aktualisht në Shqipëri po përballen me sfida që vijnë nga pengesa të tjera ligjore dhe fiskale. Drejtimi ekonomik i ardhshëm i Republikës së Shqipërisë varet shumë nga efektiviteti i masave ekonomike, financiare dhe monetare të ndërmarra nga Qeveria së bashku me zhvillimet në reformat ligjore, rregullatore dhe politike.
Drejtimi i Shoqërisë nuk është në gjendje të parashikojë të gjitha zhvillimet në mjedisin ekonomik të cilat do të kenë një impakt në veprimet e Shoqërisë dhe për pasojë mund të kenë efekt në pozicionin financiar të Shoqërisë. Në klimën aktuale të zbatimit të legjislacionit egzistues, drejtimi beson se nuk ka detyrime të rëndësishme për dëmtimet mjedisore

Çështjet ligjore

Herë pas here dhe gjatë kursit normal të biznesit, janë ngritur çështje kundër Shoqërisë. Në bazë të vlerësimeve të tij, manaxhimi i Shoqërisë është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale mbi shumat e parashikuara në këto pasqyra financiare.

Kushtëzimet tatimore

Sistemi tatimor në Shqipëri është relativisht i ri dhe karakterizohet nga ndryshime të shpeshta në legjislacion, deklarime zyrtare dhe vendime gjyqësore të cilat shpesh janë të

G.P.G.CO SH.P.K NPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

paqarta, kontradiktore dhe subjekt i interpretimeve të ndryshueshme nga autoritete të ndryshme tatimore. Tatimet dhe taksat janë subjekt i rishikimit dhe investigimit nga një numër autoritetesh të cilët kanë autoritetin të vendosin detyrime, gjoba dhe interesa të larta. Të dhënat e një viti fiskal mbeten të hapura për rishikim nga autoritetet tatimore gjatë pesë viteve të ardhshëm kalendarikë; megjithatë, në disa rrethana një vit fiskal mund të mbetet i hapur për një kohë të gjatë. Ngjarjet e fundit në Shqipëri sugjerojnë që autoritetet tatimore të marrin një pozicion më të sigurtë dhe kategorik në interpretimet e tyre dhe në zbatimin e legjislacionit tatimor.

Këto rrethana mund të krijojnë rrezikun tatimor në Shqipëri që është shumë më i rëndësishëm sesa në vende të tjera. Drejtimi beson se ka njohur detyrimet tatimore në bazë të interpretimeve të legjislacionit aktual tatimor në Shqipëri, deklaratave zyrtare dhe vendimeve gjyqësore. Megjithatë, interpretimet e ndryshme të disa autoriteteve për zbatim mund të ndikojë ndjeshëm në zërat e këtyre pasqyrave financiare.

Shënimi 6 – Aktivet afatgjata materiale

Analiza e Aktiveve Afatgjata Materiale paraqiten për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

	Toka+Ndertime		Mak.pajisj	Te tjera	Totali
Aktive te Trupezuara					
Gjendje 01.01.2022	**79,216,414**	**0**	**412,720,209**	**214,642,528**	**706,579,151**
Shtesa	5,000,000		119,475,338	7,381,689	**131,857,027**
Pakesime	0		(28,058,400)	(757,159)	(28,815,559)
Gjendje 31.12.2022	**84,216,414**	**0**	**504,137,147**	**221,267,058**	**809,620,619**
Amortizimi					
Gjendje ne 01.01.2022	**6,390,729**		**264,619,302**	**117,788,405**	**388,798,436**
Shtesa llogaritur	**1,983,114**		**34,520,064**	**19,798,980**	**56,302,158**
Pakesime	0		0	(456,199)	(456,199)
Gjendje ne 31.12.2022	**8,373,843**		**299,139,366**	**137,131,186**	**444,644,395**
Vlera neto 01.01.2022	72,825,685		148,100,907	96,854,123	317,780,715
Vlera neto 31.12.2022	**75,842,571**		**204,997,781**	**84,135,873**	**364,976,225**

Shenimi 7 - Investime ne pjesmarrje

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Tituj pronësie në shoqerine "Hidroalbania Energji" shpk	315,008,249		394,508,309
Tituj pronësie në shoqerine "Hidroalbania" shpk	66,000		66,000
Tituj pronësie në shoqerine "Egnatia Hydropower"shpk	100,250		

Tituj pronësie në shoqerine "Egnatia Hydropower" shpk	222,700,000		8,200,250
Tituj pronësie në shoqerine " Beta" shpk	82,340,068		87,047,200
Totali	**620,214,567**		**489,821,759**

Shenim 8 - Aktivet biologjike

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Aktive biologjike (Vreshta dhe pemtore)	92,329,341		92,329,341
Totali	**92,329,341**		**92,329,341**

Shenimi 9 -Inventaret

	31 Dhjetor 2022		**31 Dhjetor 2021**
Materiale te para	23,732,992		44,582,813
Totali	**23,732,992**		**44,582,813**

Shënimi 10- Llogari të arkëtueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme

	31 Dhjetor 2022		**31 Dhjetor 2021**
Nga aktiviteti i shfrytezimit,kliente	2,881,304,719		2,021,606,668
Debitore te tjere	51,552,896		51,346,242
Furnitore debitore	42,933,758		235,406,905
Parapagime te dhena	733,243,800		71,784,611
Tvsh e zbritshme	0		68,058
Tatimi mbi fitimin	0		11,124,662
Totali	**3,709,035,172**		**2,391,337,146**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Import Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

Shënimi 11 – Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Para ne dore	-		64,280
Para ne Banka	639,519,410		629,160,624
Totali	**639,519,410**		**629,224,905**

Shënimi 12 – Kapitali aksionar

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Katitali i nenshkruar	1,550,270,990		1,286,270,990
Totali	**1,550,270,990**		**1,286,270,990**

Shënimi 13 – Rezerva të tjera

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Rezerva ligjore	100,000,000		100,000,000
Rezerva te tjera	189,532,056		265,178,055
Totali	**289,532,056**		**365,178,055**

Shënimi 14 – Fitime të pashpërndara

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Fitimi/Humbja e vitit	507,059,557		288,354,001
Totali	**507,059,557**		**288,354,001**

Shënimi 15 – Huatë afatgjata

	31 Dhjetor 2022		**31 Dhjetor 2021**
Huate afatgjata	231,891,799		19,256,215
Te tjera te pagueshme	1,167,406,808		743,466,664
Totali	**1,399,298,607**		**762,722,879**

Shënimi 16– Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme

	31 Dhjetor 2022		**31 Dhjetor 2021**
Arkëtime në avancë për porosi	109,462,326		125,592,634
Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,649,851,134		1,193,288,549
Te pagueshme ndaj punonj.dhe sig.shoqerore	9,308,090		5,651,750
Totali	**1,768,621,550**		**1,324,532,933**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Import Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

Shënimi 17 – Huamarrje afatshkurtra

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Overdraft bankar	-		48,475,972
Totali	**-**		**48,475,972**

Shënimi 18 –Detyrime per tatimin aktual

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Tatimi mbi vleren e shtuar (Tvsh)	10,343,685		0
Tatimi mbi te ardhurat personale	1,573,245		1,590,318
Tatimi mbi fitimin	37,967,667		0
Totali	**49,884,597**		**1,590,318**

Shënimi 19– Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Dorezim punime e sherbime	4,136,034,731		3,406,399,547
Te ardhura te tjera	28,301,760		2,604,945
Punime nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar	-		25,973,750
Totali	**4,164,336,491**		**3,434,978,242**

Te ardhurat e deklaruara ne FDP per vitin 2022 jane per Shumen **4,148,206,183** leke ndersa ne te ardhurat e deklaruara ne bilancin e vitit 2022 jane **4,164,336,491** leke , te cilat nuk rakordojne me te ardhurat e Fdp-se per Shumen 16,130,308 leke (Te ardhurat ne bilanc jane me shume ne vleren 16,130,308 leke) . Ky mosrakordim vjen per shkak te faturave te paradhenieve sipas kontratave me entet publike , konkretisht faturat e paradhenieve me FSHZH per
tenderat .

Shënimi 20 - Të ardhura të tjera

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Të ardhura të tjera korente	-		32,363,680
Totali	**-**		**32,363,680**

Shënimi 21– Lëndë të para dhe të konsumueshme të përdorura

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021

Materiale te para	2,019,734,946		2,019,734,946
Totali	**2,019,734,946**		**2,019,734,946**

Shënimi 22 - Shpenzime personeli

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Paga	153,598,307		147,752,263
Sigurime shoqerore	24,185,554		23,096,370
Te tjera shpenzime per pagat dhe sigurimet			0
Totali	**177,783,861**		**170,848,633**

Shënimi 23 - Te ardhura/shpenzime financiare neto

Te ardhura dhe shpenz. nga kembimet valutore			
	31 Dhjetor 2022		**31 Dhjetor 2021**
Fitim nga kembime valutore monetare			
Humbje nga kembimet valut. monetare	(43,390,950)		(4,451,029)
Shuma	**(43,390,950)**		**(4,451,029)**
Te ardhura dhe shpenzime nga interesat			
	31 Dhjetor 2022		**31 Dhjetor 2021**
Te ardhura nga interesat	408,652		441,660
Shpenzime nga interesat	(1,551,307)		(2,240,409)
Shuma	**(1,142,655)**		**(1,798,749)**
Totali	**(44,533,605)**		**(6,249,778)**

Shënimi 24 - Shpenzime te tjera (te shfrytezimit)

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Primi i sigurimit	7,193,904		10,668,913
Energji elekrike,uje	5,077,195		2,957,546
Sherbime , blerje te tjera	82,528,829		81,469,395
Punime nga te tretet	949,709,067		648,350,417
Mirembajtje dhe riparime	58,087,063		52,428,801
Reklame publicitet	43,466,572		40,642,769

Reklame publicitet	43,466,572		40,642,769
Shpenzime transporti	4,888,211		7,409,384
Transferime,udhetim me dieta	71,580,400		51,950,000
Shpenzime telefon	1,259,741		1,141,154
Sherbime bankare & kom Garancie	7,683,196		4,044,789
Taksa	5,931,559		6,365,759
Shpenzime per pritje e perfaqsime	716,601		2,451,077
Gjoba, penalitete, demshperblime	2,515,633		86,921
Vlera kontabel e AAM-ve te shitura	28,359,360		395,780
Totali	**1,268,997,331**		**910,362,705**

Shënimi 25 - Fitimi para tatimit

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Fitim Bruto	596,984,590		339,255,340

Shënimi 26 - Shpenzime te pa Zbriteshme

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Shpenzime te pa Zbriteshme	2,515,633		86,921

Shënimi 27 - Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	89,925,033		50,901,339

Shënimi 28 - Fitimi për periudhën

	31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	**507,059,557**		**288,354,001**

Shënimi 29 - <u>Sqarim per Shpenzimet sipas bilancit dhe shpenzimet sipas FDP-ve :</u>

SHPENZIMET 2022			
BLERJET SIPAS FDP DHE SIT	**3,248,033,707**	-	
1.Blerje per investime	**74,282,234**	-	
Blerje investime brenda vendit pa tvsh (23)	7,494,504		
Importe te perjashtuara te investimit pa tvsh (24)	7,835,872		
Importe te investimit me tvsh 20% (28)	26,773,095		
Blerje te investimit brenda vendit me tvsh 20% (32)	32,178,763		
2.Blerje mallra dhe sherbime etj	**3,173,751,473**	-	
Blerje te perjashtuara (22)	1,243,108,398		

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import - Eksport G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

Importe mallra te perjashtuar 25	107,869,276		
Importe mallra me shkalle tatimore 20% (26)	46,871,707		
Blerje nga furnitor vendas me shkalle tatimore 20% (30)	1,775,885,592		
Blerje brenda vendit 6%	16,500		
SHPENZIME SIPAS BILANCIT		**ME FATURA**	**PA FATURE**
DEKLARATA E TATIM FITIMIT	**3,567,351,901**		
Blerje e AAM-ve	-	-	
Mallra lend te pare sherbime	2,019,734,946	2,019,734,946	
Pagat + sig shoq	177,783,861	-	177,783,861
Amortizimi	56,302,158		37,560,954
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	1,268,997,331	1,156,616,383	112,380,948
Interesa	1,142,655	1,398,504	(255,849)
Humbjet nga kembimet valutore	43,390,950		43,390,950
Fitimi nga kembimet valutore/Fitimi	-		-
TOTALI SHPENZIMEVE	**3,567,351,901**	**3,177,749,833**	**389,602,068**
Ndryshimi gjendjes Inventarit	-	(20,849,820)	
Likujdimi I Principalit Leasing me fat tatimore	-	32,919,070	
Parapagime per inventar (me fature tatimore)		(28,850,854)	
	3,567,351,901	**3,160,968,229**	**389,602,068**
Diferenca		**(12,783,244)**	

Diferenca prej 12,783,244 leke qe rezulton ndermjet blerjeve te deklaruara ne FDP, krahasuar me blerje e deklaruara ne bilanc dhe ne PASH, vjen si rezultat i vleres doganore te mallrave me koston faktike te tyre, per efekt te references.

1.Blerje per investime ne bilanc		**ME FATURA**	**PA FATURE**
Blerje AAM	**131,857,027**	**70,043,965**	61,813,062
Blerje AA biologjike	-	-	
	131,857,027	**70,043,965**	**61,813,062**
Blerje investime sipas fdp-ve		74,282,234	
Diferenca SIT Blerje me fature dhe kostos faktike		**(4,238,269)**	

Diferenca prej 4.238.269 leke vjen si rezultat I differences ndermjet kostos faktike te aktiveve me vleren doganore te tyre per efekt te references dhe te transportit.
Shenim vlera e aktiveve te blera pa fature tatimore per shumen 61.813.062 leke vjen si rezultat i kontratave te Leasing qe eshte per vleren e aktivit 61.813.062 leke

Hartucesi i Pasqyrave
Olsa Ziu

Administrator i shoqerisë
Paqsor Buzi

REPUBLIKA E SHQIPERISE Import - Export G.P.G.CO SH.P.K NIPT:J64324443V LUSHNJE ALBANIA

MERITA MUZINA
AUDITUES LIGJOR

RRUZHDI SHKULLAKU
AUDITUES LIGJOR

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Mbi pasqyrat financiare 1 Janar – 31 Dhjetor 2022

Drejtuar: Asamblese se Pergjithshme të shoqerisë "G.P.G COMPANY" shpk

Adresa: Lagja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondes se Plukut, Lushnje

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare **"G.P.G COMPANY" shpk**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2022, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "G.P.G COMPANY" shpk me datën 31 Dhjetor 2022, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF-të) dhe me Ligjin 25/2018 per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit

Opinioni yne mbi paqsyrat financiare nuk mbulon informacione të tjera dhe ne nuk shprehim ndonje konkluzion që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Ne lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjesinë që ti lexojme informacionet e tjera, dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kane inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duken se janë me anomali materiale. Nëse bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione, ka një anomali materiale, atëherë ne duhet te

raportojmë për këtë fakt. Ne nga informaionet që kemi siguruar para datës së raportit të auditimit, nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në perputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi gjykon te nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Audituesi Ligjor

Merita Muzina

AUDITUES LIGJOR
MERITA MUZINA
Liç. Nr. 423
NIPT: K81611501Q

Audituesi Ligjor

Rruzhdi Shkullaku

Rruzhdi Shkullaku
Ekspert Kontabilitet Regjistruar
Nr. Licencës 209
NIPT: K33715746D
Tel: 083 22 6226
Cel: 069 40 30 317
POGRADEC, ALBANIA

Lushnje me 30.03.2023